

		ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Njësia:		Nr. Prot.:	48/2022
Unit:	KO	Prot. No.:	
Jedinita:		Br. Prot.:	
Nr. i faqeve:	-11-	Data:	27.12.2022
No. of pages:		Datum:	
Br. stranica:			
Prishtinë			



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

RREGULLORE

PËR

DHËNIEN E DEKORATAVE DHE ÇMIMEVE VJETORE

E OMK-SË

Prishtinë, dhjetor 2022

KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 22, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 dhe Nenit 23 të Statutit të OMK-së, si dhe Nenit 23 paragrafi 2 të Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK-së, e miratuar në mbledhjen e rregullt të datës 25 nëntor 2020, e plotësuar dhe ndryshuar në mbledhjen e rregullt të datës 27 dhjetor 2022, Kuvendi i OMK-së miraton këtë:

RREGULLORE
PËR
DHËNIEN E DEKORATAVE DHE ÇMIMEVE VJETORE E OMK-SË

(Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara sipas Vendimit nr. 42/2022 të Kuvendit të OMK-së, datë 27 dhjetor 2022)

Kapitulli i I-rë - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohet procedura dhe mënyra e dhënies së dekoratave dhe çmimeve vjetore të Odës së Mjekëve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Oda).

Neni 2

Fushëveprimi

Dekoratat e Odës dhe çmimet vjetore të Odës janë mirënjohjet e dhëna nga Oda për anëtarët e saj të shquar, si dhe për individë të tjerë, institucione, organizata dhe persona juridik për kontribut të veçantë ndaj Odës dhe promovimin e saj në Republikën e Kosovës dhe jashtë vendit, për kontribut të veçantë në promovimin dhe ruajtjen e vlerave më të larta të klasës mjekësore dhe të profesionit të mjekut si dhe në përmirësimin dhe zhvillimin e veprimtarisë mjekësore.

Neni 3

Përkufizimet

Të gjitha shprehjet në vijim, kudo që përdoren në këtë Rregullore kanë kuptimin e përshkruar si më poshtë, përveç në rastet kur konteksti në të cilin një shprehje e tillë shfaqet, qartë ka një kuptim tjetër.

OMK - Oda e Mjekëve të Kosovës.

Dekorata e OMK-së - Vlerësimi më i lartë i OMK-së për anëtarët kontribut dhënës në fushën e mjekësisë.

Çmimet vjetore të OMK-së - të cilët jepen për anëtarët që kanë të arritura shkencore në fushën e mjekësisë.

Mirënjohja e OMK-së - e cila u jepet anëtarëve të Odës dhe individëve të tjerë, institucioneve, organizatave, shoqatave dhe personave juridik për dhënien e kontributit të çmueshëm në punën dhe organizimin e Odës.

Medalja përkujtimore e OMK-së - e cila i jepet një anëtarit të Odës pas daljes në pension ose pas vdekjes si shenjë mirënjohjeje dhe falënderimi për kontributin e dhënë.

Këshilli Drejtues i OMK-së - Organ i Odës së Mjekëve të Kosovës.

Komisioni për Dhënien e Dekoratave i OMK-së - Organ i OMK-së, i cili është përgjegjës për shqyrtimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen e kërkesave për dhënien e dekoratave.

Stafi Asistues i Komisionit (zyrtar ligjor, asistent administrativ) - Zyrtar të Shërbimit Profesional të OMK-së të cilët i ofrojnë asistencë ligjore dhe administrative Komisionit.

Buxheti - Linja buxhetore e ndarë për dekorata dhe çmime.

Kapitulli i II-të - DEKORATAT E ODËS

Neni 3

Llojet e dekoratave

1. Oda e Mjekëve të Kosovës do të ketë 4 lloje të dekoratave, si në vijim:

1.1. Dekorata Nderi i Mjekut “Ali Sokoli”;

1.2. Dekorata për arritje shkencore “Musa Haxhiu”;

1.3. Mirënjohja e Odës së Mjekëve të Kosovës;

1.4. Medalja përkujtimore e Odës së Mjekëve të Kosovës.

Neni 4

Dizajni i dekoratave

Pamja vizuale (dizajnimi) i llojeve të dekoratave të dhëna nga OMK sipas Nenit 3 të kësaj Rregulloreje përcaktohet nga Këshilli Drejtues i Odës.

Neni 5

Dekorata NDERI I MJEKUT “ALI SOKOLI”

Dekorata e Nderit, si vlerësimi më i lartë i Odës, u jepet anëtarëve të Odës për arritje të jashtëzakonshme gjatë ushtrimit të profesionit të mjekut në situata të krizës sociale ose në rrethana të tjera të jashtëzakonshme ose të rrezikshme për jetën, si dhe për arritje të jashtëzakonshme profesionale që kanë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme nivelin ekzistues të ofrimit të kujdesit shëndetësor, veprimtarinë në kujdesin shëndetësor dhe sistemin e kujdesit shëndetësor në tërësi.

Neni 6

Dekorata për arritje shkencore dhe inovacion “MUSA HAXHIU”

1. Dekorata për arritje shkencore dhe inovacion e Odës së Mjekëve të Kosovës u jepet anëtarëve të Odës të cilët kanë të arritura të vërtetuara në fushën e mjekësisë, me kontributin e shprehur në nivel evropian dhe botëror.
2. Dekorata për inovacion sipas paragrafit 1 të këtij Neni i jepet anëtarëve të OMK-së që sjellin risi në fushën e mjekësisë dhe të cilat janë të patentuara dhe që bëhen në nivel vendor, evropian dhe botëror.

Neni 7

MIRËNJOHJA E ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS

Mirënjohja e Odës së Mjekëve të Kosovës u jepet anëtarëve të Odës dhe individëve të tjerë, pas daljes në pension, institucioneve, organizatave, shoqatave dhe personave juridik për dhënien e kontributit të çmueshëm në punën dhe organizimin e Odës dhe për dhënien e kontributit në promovimin e vlerave të Odës e për ndihmën në realizimin e detyrave, programeve, projekteve dhe qëllimeve thelbësore të Odës në Republikën e Kosovës dhe jashtë vendit.

Neni 8

MEDALJA PËRKUJTIMORE E ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS

Medalja përkujtimore e Odës së Mjekëve të Kosovës i jepet një anëtari të Odës pas vdekjes si shenjë mirënjohjeje dhe falënderimi për anëtarësi të përgjegjshme shumëvjeçare dhe kontribut në punën e Odës së Mjekëve të Kosovës, si dhe në dhënien e shërbimeve shëndetësore popullatës së Kosovës.

Kapitulli i III-të - KOMISIONI PËR DHËNIEN E DEKORATAVE TË ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS

Neni 9

Përbërja e Komisionit për dhënien e dekoratave

1. Këshilli Drejtues i Odës, me propozim të Kryetarit të Odës, emëron Komisionin për dhënien e dekoratave (në tekstin e mëtejme: Komisioni).
2. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë të Odës, nga përbërja e të cilit zgjidhet Kryetari dhe nënkryetari i Komisionit.
3. Detyrat administrative për nevojat e Komisionit ofrohen nga Asistenti administrativ i Shërbimit Profesional të OMK-së, i cili emërohet nga Kryetari i Odës.
4. Asistenca juridike Komisionit i ofrohet nga Zyrtari Ligjor i Shërbimit Profesional të OMK-së, i cili emërohet nga Kryetari i Odës.
5. Mandati i Komisionit përcaktohet nga organi i cili e ka emëruar, përkatësisht Këshilli Drejtues i OMK-së.
6. Nëse kryetari i Komisionit ose një anëtar i Komisionit mungon pa arsye më shumë se tre herë në takimet e Komisionit ose nuk i përmbush detyrat e veta në punën e Komisionit, Kryetari i Odës mund t'i propozojë Këshillit Drejtues të Odës shkarkimin e tij dhe emërimin e një anëtari të ri.

Neni 10

Fushëveprimtaria e Komisionit

1. Komisioni mbledh dhe shqyrton propozimet për dhënien apo revokimin e dekoratave dhe përgatit propozimin përfundimtar për dhënien e dekoratave.
2. Propozimi për dhënien apo revokimin e dekoratave mund t'i dorëzohet Komisionit drejtpërdrejtë nga Kryetari i Odës ose tërthorazi nga anëtarët e Odës përmes Komisioneve të institucioneve të ndryshme. Anëtarët e Odës nuk mund ta propozojnë vetveten për dhënien e dekoratës së Odës.
3. Të gjitha propozimet për dhënien apo revokimin e dekoratave të Odës dorëzohen me shkrim, me formularin e përkryer të propozimeve për dhënien e dekoratave me shpjegimin përkatës, i cili mund të gjendet në ueb-faqen zyrtare të Odës.

Neni 11

Mbarëvajtja e takimeve të Komisionit

1. Mbledhja e Komisionit thirret nga Kryetari i Komisionit, në mungesë të tij edhe nga nënkryetari i Komisionit.
2. Mbledhja e Komisionit mund të mbahet nëse janë të pranishëm të paktën më shumë se gjysma e anëtarëve të zgjedhur të Komisionit.
3. Asistenti administrativ i Komisionit duhet t'i njoftojë përmes e-mailit, anëtarët e Komisionit për datën dhe kohën e mbajtjes së mbledhjes së paku tre ditë para mbledhjes së caktuar.
4. Anëtarët e Komisionit votojnë hapur dhe vendimi mbi propozimin përfundimtar të Komisionit është i vlefshëm nëse më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm kanë votuar për vendimin.
5. Nëse kandidati për dhënien e dekoratës nuk i plotëson kushtet për dhënien e dekoratës së propozuar, Komisioni mund të shqyrtojë, për aq sa është e mundur, propozimin për dhënien e një dekorate tjetër.

6. Revokimi i dekoratës nga ana e Komisionit bëhet vetëm duke u bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës për revokim të dekoratës.

Neni 12 Vendimmarrja

1. Dhënia e dekoratave vendoset nga Këshilli Drejtues i OMK-së në bazë të propozimit përfundimtar të Komisionit, përveç dekoratës “Mjeku i Nderit” e Odës së Mjekëve të Kosovës, për të cilën është i nevojshëm miratimi paraprak i Kryetarit të Odës.
2. Për kohën, vendin dhe mënyrën e dhënies së dekoratave vendos Këshilli Drejtues i Odës ndërkaq dekoratat i dorëzon Kryetari i Odës ose personi i autorizuar prej tij.

Neni 13 Publikimi i vendimeve

Vendimi për dhënien dhe revokimin e dekoratave publikohet në buletinet e Odës dhe përfshihet në një Libër të veçantë të dekoratave i cili mbahet në arkivin e Odës.

Kapitulli i IV -të ÇMIMET VJETORE TË ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS

Neni 14

Kriteret për ndarjen e çmimeve vjetore

1. Çmimet vjetore të Odës së Mjekëve të Kosovës ndahen mbi katër baza:
 - 1.1 Anëtarit të Odës i cili me punën e vet profesionale në praktikën mjekësore ka arritur rezultatet më të spikatura profesionale gjatë vitit të kaluar kalendarik në fushën e profesionit të mjekut.
 - 1.2 Anëtarit të Odës i cili duke botuar punën e vet origjinale shkencore në vitin e referuar në revistat shkencore me faktorin e indeksuar të ndikimit (*Impact factor*) në bazën e të dhënave *Web of Science*, ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në përmirësimin e profesionit të mjekut. Nëse anëtari i Odës ka publikuar disa punime në revista përkatëse shkencore në vitin e referuar atëherë mbledhen faktorët e tij të ndikimit dhe arrihet e ashtuquajtura shumë e faktorëve të ndikimit. Nëse disa anëtarë të Odës kanë të njëjtën shumë të faktorëve

ndikues të punimeve shkencore, çmimi vjetor i Odës së Mjekëve të Kosovës do t'i jepet anëtarit të Odës i cili është autori i parë në më shumë punime shkencore të këtilla.

- 1.3. Anëtarit të Odës i cili në mënyrë të veçantë, me veprimtari të jashtëzakonshme ka mbrojtur të drejtat e mjekëve dhe ka kontribuar në promovimin e interesave të mjekësisë kosovare.
- 1.4. Gazetarit ose personit i cili me veprimtarinë e vet ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në fuqizimin e reputacionit të mjekëve kosovar, dhe promovimin e profesionit të mjekut në publik.
2. Çmimi vjetor i Odës së Mjekëve të Kosovës i jepet anëtarit të Odës të cekur në paragrafin 1, pika 1.2 e këtij neni, ndarazi, në dy kategori, përkatësisht:
 - 2.1. Mjekëve shkencëtarë të moshës mbi 40 vjeç, dhe
 - 2.1. Mjekëve shkencëtarë të rinj të moshës deri 40 vjeç.
3. Këshilli Drejtues i Odës vendos mbi vlerën monetare dhe formën e çmimit, si dhe pamjen e mirënjohjes me shkrim të çmimit vjetor të Odës së Mjekëve të Kosovës.
4. Propozimi për dhënien e çmimeve vjetore të Odës mund t'i dorëzohet Këshillit Drejtues drejtpërdrejtë nga Kryetari i Odës ose anëtarët e Këshillit Drejtues të Odës, ose tërthorazi nga secili anëtar i Odës me arsyetimin përcjellës.
5. Gjatë një viti mund të jepet vetëm një çmim vjetor i Odës së Mjekëve të Kosovës mbi secilën bazë të cekur në paragrafin 1 të këtij neni, dhe për secilën kategori të referuar në paragrafin 2 të këtij neni.
6. Këshilli Drejtues i Odës vendos mbi dhënien e çmimit vjetor të Odës së Mjekëve të Kosovës, si dhe dhënien e shpërblimit për dekoratën për inovacion varësisht nga mjetet që buxheti i Odës ka në dispozicion.
7. Nëse në një vit të caktuar nuk ka asnjë kandidat i cili plotëson kriteret e cekura në paragrafin 1 të këtij neni mbi një bazë të veçantë ose nga paragrafi 2 i këtij neni për një kategori të veçantë të dhënies së çmimit, çmimi vjetor i Odës së Mjekëve të Kosovës nuk do të jepet mbi atë bazë ose në atë kategori për atë vit.

8. Çmimin vjetor të Odës së Mjekëve të Kosovës e dorëzon Kryetari i Odës, ose një person i autorizuar prej tij një herë në vit në një ceremoni të organizuar nga Oda.

9. Vendimi për dhënien e çmimit vjetor të Odës së Mjekëve të Kosovës publikohet në ueb-faqen zyrtare të Odës dhe në Revistën e Odës.

Kapitulli i V-të - PROCEDURA PËR REVOKIMIN E DEKORATAVE

Neni 15

Revokimi i dekoratës

1. Revokimi i dekoratës bëhet :

1.1. Të dekoruarit mund t'i revokohet dekorata nëse vepron në kundërshtim me Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore dhe kryen vepra të tjera të dënueshme me ligjet në fuqi që e bëjnë të padenjë për bartjen e dekoratës;

1.2. Propozimin për revokimin e dekoratës mund ta bëjë propozuesi për dekoratë apo Komisioni;

1.3. Kryetari i Odës me aprovim të Këshillit Drejtues nxjerrë vendim për revokimin e dekoratës anëtarit të Odës.

Kapitulli i VI-të - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Dispozitat kalimtare

1. Bashkëngjitur me këtë Rregullore publikohet formulari i propozimeve mbi dhënien e dekoratave dhe çmimeve vjetore të Odës i cili është pjesë përbërëse e saj.

2. Ndeshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen sipas të njejtës procedurë së miratimit.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i OMK-së dhe nënshkrimit nga Kryetari i OMK-së.

27 dhjetor 2022, Prishtinë

Dr.Pleurat Sejdiu, Mr.sci

Kryetari i OMK-së

